



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 26/
01 Prot.

Datë 25.01.2017

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Rrogozhinë

Drejtuar: Z. Beqir NUREDINI
Kryetar
Bashkia Rrogozhinë

I nderuar Z. Nuredini,

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 45 Prot., datë 06.12.2016, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 26 Prot., datë 11.01.2017 me lëndë “Kërkesë për Aktin e Përputhshmërisë, për Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Rrogozhinë”, Ju bëjmë me dije se:

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, pas verifikimeve konstatoi se Bashkia Rrogozhinë në shkresën e saj, nuk ka bashkëlidhur materialet e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, objekt shqyrtimi nga ana Jonë.

Referuar nenit 57 “Miratimi i PPV-së”, pika 8, gërma a) të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, bëjmë me dije se nevojitet dokumentacioni i plotë, për nisjen e shqyrtimit të dokumenteve të PPV-së Bashkia Rrogozhinë dhe për dhënien e Aktit të Përputhshmërisë.

Gjithashtu, bazuar në Nenin 11 “Botimi në Regjistrin e Integruar të Territorit”, të Rregullores së Planifikimit, Ju sjellim në vëmendje detyrimin e bótimit në Regjistrin e Integruar të Territorit (RIT) të materialit të plotë të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Rrogozhinë, objekt shqyrtimi.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME



Konceptoi, punoi: B.Laci, F.Mali
Datë: 25.01.2017
Nr. Kopje: 2